

VENDIM

Nr. 1 datë 02/04/2021

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.70, DT.29.10.2019 TË ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME “PËR PËRCAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE QË PËRFAQËSOJNË FSHZH NË CILËSINË E ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË AGJENCIA EKONOMIKE MBËSHTETËSE SH.P.K (AEM SH.P.K)

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 10130, dt. 11.05.2009 “Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit”, të ndryshuar, nenit 13 të statutit të Fondit Shqiptar të Zhvillimit miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues Nr.82, dt.17.07.2009, i ndryshuar, Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, Vendimi Nr.70, dt. 29.10.2019 të Asamblesë së Përgjithshme “Percaktimin e përfaqësuesve që përfaqësojnë FSHZH në cilësinë e ortakut të vetëm të Shoqërisë Agjencia Ekonomike Mbështetëse sh.p.k (AEM sh.p.k), Asambleja e Përgjithshme,

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit nr. 70 datë 29.10.2019 të Asamblesë së Përgjithshme, ndryshohet si më poshtë vijon:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit që përfaqëson ortakun e vetëm të Shoqërisë Agjencia Ekonomike Mbështetëse sh.p.k (AEM sh.p.k), do të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme të kësaj shoqërie, me përfaqësuesit si më poshtë:

- Drejtori Ekzekutiv
- Drejtori i Departamentit të Monitorimit dhe i Auditimit.
- Drejtori i Departamentit të infrastrukturës
- Drejtori i Departamentit të Zhvillimit Rajonal
- Drejtori i Departamentit të Financës
- Departamenti i Menaxhimit të Projekteve/Programeve.
- Drejtori i Departamentit Juridik dhe Prokurimeve
- Drejtori i Departamentit të Funksioneve Mbështetëse

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, i njoftohet të gjithë Departamenteve dhe depozitohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Dritan AGOLLI

Kryetar

Dritan RRESHKA

Anëtar

Arben SKËNDERI

Anëtar

Enkelejda MYFTARI

Anëtar

Gentian KERRI

Anëtar

Etleva JOTI

Anëtar

Ilda KUCOVA

Anëtar